



Datë: 23.06.2026

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 12 të Rregullores së Ministrisë së Financave (MF) Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores (K.FK) Nr. 83, datë 14.06.2013, për Ndarjen e Subvencioneve, si dhe nenit 44 të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës Nr. 98, i datës 17.08.2012, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetjen financiare publike për projekt-propozimet e OJQ-ve dhe Individëve në fushat e kulturës, rinisë dhe sportit.
2. Për implementimin e thirrjes publike zbatohen dispozitat e Rregullores (MF) Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të Organizatave Joqeveritare dhe Rregullores (K.FK) Nr. 83, datë 14.06.2013, për Ndarjen e Subvencioneve për individët.
3. Për realizimin e mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve për projekt-propozimet në fushat e Kulturës, Rinisë dhe Sportit vlejné këto kushte:
 - 3.1. Mjetet financiare për mbështetje tërhiqen nga kodi i subvencioneve për mbështetjen e organizatave joqeveritare dhe individëve që promovojné avancimin, fuqizimin dhe masivizimin e kulturës, rinisë dhe sportit;
 - 3.2. Mbështetja financiare publike për projekt-propozimet e OJQ-ve dhe individëve do të ofrohet nga Buxheti i planifikuar për këtë thirrje nga fondi burimor 21, kodi ekonomik 85002, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në vlerë totale prej **400,000.00 €**;
 - 3.3. Shuma minimale e mbështetjes financiare për OJQ-të është **500.00 €**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **8,000.00 €**.

3.4. Për mbështetje financiare për Individë zbatohen dispozitat e Rregullores (K.FK) Nr. 83, datë 14.06.2013, për Ndarjen e Subvencioneve.

4. Mjetet financiare të planifikuara në pikën 3, nën pika 3.2, do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekt-propozimeve sipas dokumentacionit të vlefshëm për zbatimin e thirrjes, i cili është pjesë e këtij vendimi.
5. Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetje financiare është 15 ditë pune dhe fillon në ditën e publikimit të thirrjes publike. Afati i fundit për dorëzim të projekt-propozimeve është deri më **13.07.2026**.
6. Organizatat Joqeveritare, shoqatat, klubet dhe individët mund të aplikojnë vetëm me një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrjeje dhe vetëm në njërin nga fushat prioritare të përcaktuara. Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi një (1) muaj dhe maksimumi gjashtë (6) muaj.
7. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë sipas Udhëzuesit për Aplikim.
8. Dokumentacioni i kompletuar, në dy kopje fizike dhe një kopje elektronike (në CD) brenda zarfit të mbyllur, duhet të dorëzohet drejtpërdrejt në Zyrën Pritëse për shërbimin e qytetarëve ose përmes postës në adresën: *Komuna e Fushë Kosovës, 12000, Rr. Tahir Zëmaj, Objekti i Komunës, Departamenti i DKRS-së*. Çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike në e-mail adresën: agron.breznica@rks-gov.net.
9. Vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve e bën Komisioni Vlerësues, pasi të konstatohet se aplikantët i plotësojnë kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit, sipas kritereve të thirrjes publike.

10. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzuesin për Aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren (MF) Nr. 04/2017 për financimin publik të OJQ-ve dhe Rregulloren (K.FK) Nr. 83, datë 14.06.2013, për Ndarjen e Subvencioneve.

11. Pasi të merret vendimi për financim për aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet e financimit, Kryetari i Komunës, i mbështetur në rekomandimin e Komisionit Vlerësues, merr vendim për ndarjen e mjeteve financiare për OJQ-të dhe individët që merren me përkrahjen, fuqizimin dhe masivizimin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

12. Përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Fushë Kosovës.

13. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Sqarim i rëndësishëm: OJQ-të dhe individët të cilët nuk i kanë mbyllur projektet paraprake (nuk kanë dorëzuar dëshminë e realizimit të projektit dhe raportin financiar), nuk do të shqyrtohen fare nga Komisioni për Vlerësim.

Akti u dorëzohet:

- 1 x Kryetarit të Komunës
- 1 x Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- 1 x Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1 x Arkivit të Komunës

Kryetari i Komunës
Valon Prebreza

